



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura e III-të**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja e pestë, dt. 15.04.2008  
Salla nr. C.203 ora 14,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi ndërsa mungoi Mark Krasniqi.

Në mbledhje morën pjesë ministri i arsimit Enver Hoxhaj dhe përfaqësues të MASHT-it Isni Kryeziu, Agim Bërdynaj, Mustafë Kadriu dhe Nezafete Kutillovci.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkagjiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.  
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Kryetari i Komisionit, Agim Veliu i informoi të pranishmit lidhur me punën e Komisionit në shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Më tej, kryetari kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e Ministrisë lidhur me nenet të cilat Komisioni i ka shqyrtuar dhe nuk i ka konkretizuar si neni 9.3.d) dhe neni 27.

Ministri i arsimit Enver Hoxhaj në diskutimin e tij përkrahi punën e Komisionit në amendamentimin e Projektligjit si një ligj i rëndësishëm së veçantë.

Sa i përket nenit 9.3.d) të projektligjit, ministri sqaroi se në vende të ndryshme ekzistojnë përvoja të ndryshme lidhur me bartjen e testeve.

Çështja e mbikëqyrjes dhe sigurisë policore i referohet vetëm seriozitetit të mbrojtjes së testit dhe kjo mund të rregullohet edhe me ligj.

Përfaqësuesit e ministrisë lidhur me këtë nen deklaruan se në ditën e mbajtjes së testit ekziston mbrojtja institucionale dhe kjo çështje rregullohet me udhëzim administrativ të ministrisë, por nuk përjashtuan mundësinë që kjo çështje të rregullohet me ligj.

Memli Krasniqi në diskutimin e tij paraqiti arsyen e përfshirjes së shërbimit policor në tekstin e nenit 9.3.d)

Ai tha se prezenca e shërbimit policor në bartjen e testeve konsiston në parandalimin dhe evitimin e problemeve eventuale që do të mund të ndodhin gjatë bartjes si dhe dha shpjegime për mënyrën e rregullimit të kësaj çështjeje në vendet tjera si Britani, Turqi Slloveni etj.

Anëtarët e tjerë të Komisionit Donika Kadaj, Adem Hajdaraj u pajtuan me propozimin e deputetit Memli Krasniqi që çështja e sigurisë policore duhet të figurojë në ligj dhe si e tillë nuk e rëndon ligjin.

Përfaqësuesit e ministrisë në vazhdim dhanë shpjegimet dhe arsyetimet e tyre lidhur me amendamentin e Komisionit në nenin 27 të projektligjit.

Komisioni vazhdoi me amendamentimin e Projektligjit pa prezencën e përfaqësuesve të ministrisë dhe miratuan këto amendamente:

#### Amendamenti 1

Neni 9.3.d) në fund të të fjalisë së nenit të shtohet teksti: **“shtetërore nën përcjelljen dhe sigurinë policore”**

#### Amendamenti 2

Neni 20.1 riformulohet:

**“Të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë janë të obliguara që t’i pranojnë rezultatet e arritura të kandidatëve gjatë viteve të shkollimit të mesëm (vlerësimi i brendshëm) dhe rezultatet e provimit të maturës (vlerësimi i jashtëm).**

Amendamenti 3

Neni 20.2 riformulohet:

**“Pranimi i studentëve bëhet në bazë të rezultateve të arritura:**

- **20% gjatë shkollimit të mesëm dhe të lartë,**
- **50% në provimin e maturës shtetërore,**
- **30% në vlerësimin e brendshëm të njësive akademike”.**

Neni 20.3 fshihet.

Amendamenti 4

Neni 23

Në fund të nenit fjalët: **“(katër) 4 orë”** zëvendësohen me tekstin: **“ 180 minuta”.**

Anëtarët e komisionit u pajtuan që amendamenti i propozuar nga Komisioni në mbledhjen e kaluar në nenin 27 të projektligjit të fshihet dhe të mbetet teksti si në projektligj.

Amendamenti 5

Neni 34.1 riformulohet:

**“ Rezultatet e Provimit të Maturës Shtetërore merren për bazë për pranim në Institucionet e Arsimit të Lartë gjatë vitit akademik 2011/2012.**

**Pikët: a); b) dhe c) fshihen.**

Amendamenti 6

Vërejtje teknike

Komisioni vendosi për ndryshim të pozitës së neneve në vazhdim:

**Neni 11 bëhet neni 13;**

**Neni 12 bëhet neni 11;**

**Neni 13 bëhet neni 12**

Anëtarët e Komisionit miratuan këto ndryshime dhe amendamentet e hartuara do ti procedojnë në procedurë të mëtejme në komisionet kryesore.

3. Të ndryshme

Anëtarja e Komisionit Donika Kadaj Bujupi kërkoi nga anëtarët e komisionit që mundësisht mbledhjet e Komisionit të mos mbahen ditën e martë për arsye të mbajtjes së takimit me qytetarë në komunë në këtë ditë.

Kryetari premtoi se gjatë takimit të mbledhjeve të Komisionit do ta ketë parasysh këtë kërkesë të deputetes.

Mbledhja përfundoi në orën 15,30

Kryetari i Komisionit,  
Agim Veliu